



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA SUPREME E KOSOVËS
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

Numri i lëndës: 2023:147510

Datë: 27.09.2024

Numri i dokumentit: 06218473

C-II-17-0221 C0001

Paditësi: Sh O D nga fshati K , Podujevë .

Kundër:

Të Paditurit: NSH “Ramiz Sadiku”, përfaqësuar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP), Rr. „Driton Hoxha”, nr. 55, Prishtinë, përfaqësuar nga L Z .

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit, me gjyqtarin Hasim Sogojeva , pas mbajtës së seancës dëgjimore publike, më dt. 19 shtator 2024, mori këtë :

**A K T G J Y K I M
PËR MOSPARAQITJE**

- I. HEDHET padia e paditësit Sh O D, kundër të paditurit NSH „Ramiz Sadiku ” ashtu që me të njëjtën ka kërkuar pagesën e 20 % sipas Listës Përfundimtare, dt. 07.mars 2009, edhe pjesën tjetër në shumë 5,060€.**
- II. Secila palë i heqë shpenzimet e procedurës .**

Rrethanat Faktike dhe Procedurale

Me 30.08.2013, është ushtruar padia grupore nga ish punëtorët e NSH “Ramiz Sadiku”, dhe me 10.11.2017 me urdhrin C-II-13-0338-C0001, është bërë ndarja e ankuesve veç e veç. Pas ndarjes padia e paditësit është evidentuar si C- II- 17- 0221 C0001.

Paditësi me grupin e punëtorëve është deklaruar se është përfshirë në Listën Përfundimtare të shpërndarjes së 20 % nga të hyrat e privatizimit dhe pas shpërndarjes së shumës së caktuar , mirëpo DHPGJS në bazë të një ankese të një grupi të punëtorëve ka shpallur nule Listën Përfundimtare të shpërndarjes . Pas kësaj AKP-ja ka bërë përmasimin e gabimeve dhe ka publikuar Listën tjetër më dt. 4,5 dhe 7 mars 2009.

Kolegji i Gjykatës me Aktvendim SCEL – 09- 001, kishte aprovuar ankesat e 735 punëtorëve të NSH „Ramiz Sadiku ” dhe ka urdhëruar që edhe këta punëtor të përfshihen në listën përfundimtare .

Me këtë parashtresë të padisë ka kërkuar : Aprovimin e kërkesëpadisë nga Lista përfundimtare legjitime e publikuar nga AKP më dt. 4,5 dhe 7 mars të vitit 2009. Vërtetohet e drejta e pagesës nga fondi i 20 %, si e drejtë e fituar me listën e shpallur dhe detyrohet AKP , që paditësit nga lista përfundimtare secilit punëtor t’ ia paguan shumën 5, 060.00€ .

Më dt. 22.03.2024, DHPGJS ka lëshuar Urdhër C- II- 17- 0221 si për avokatin A R me autorizim ashtu edhe për AKP-në .

Avokatit A R ju është kërkuar të plotëson parashtresën e padisë grupore , duke treguar adresën e banimit të paditësit, bazën juridike të kërkesës , provat në lidhje me vërtetimin e fekteve dhe kërkesën për çështje kryesore, ashtu që padia të jetë e kuptueshme dhe e përmbarueshme .

AKP-së ju është kërkuar të jep përgjigje në mbrojtje .

Më dt. 05.04.2024, avokati A R e ka pranuar Urdhrin, ndërsa AKP-ja më dt. 03.04.2024.

Më dt. 08.04.2024, avokati H R ka dorëzuar një parashtresë me të cilën është deklaruar se gabimisht e ka pranuar këtë urdhër, edhe pse Urdhri dhe fletë dorëzimi ju është drejtuar avokatit A R.

Më dt. 15.08.2024, Gjykata ka lëshuar njoftimin për mbajtje të seancës dëgjimore publike për dt. 20.09.2024, ashtu që njoftimi ju është dërguar paditësit Sh D si është shënuar në adresë të tij me rastin e nënshkrimit të autorizimit për avokatin A R. Njoftimin e ka pranuar më dt. 22.08.2024 Me njoftim paditësi është njoftuar për pasojën juridike të mos prezencës në seancë . Po ashtu njoftimin e ka pranuar më dt. 15.08.2024, AKP-ja .

Më dt. 16.08.2024, AKP-ja përmes përfaqësuesit të saj ka dorëzuar parashtresën e përgjigjes në padi , pas afatit ligjor me të cilën e ka kundërshtuar kërkesëpadinë e paditësit .

Më dt. 17.09.2024, paditësi ka dorëzuar një parashtresë të hartuar me dorë, me të cilën ka kërkuar të shtyhet mbajta e seancës së caktuar pasi ka theksuar se me profesion është vozitës dhe do të udhëtojë jashtë . Nuk ka dorëzuar asnjë provë që arsyeton mungesën .

Më dt. 19.09.2024, është mbajtur seanca dëgjimore publike në të cilën nuk ka prezantuar paditësi, përkundër faktit se njoftimi ju është dorëzuar më dt. 22.08.2024, ndërsa për AKP ka prezantuar me autorizim L Z.

Gjyqtari i çështjes në seancë dëgjimore dt. 19.09.2024, nuk e ka pranuar kërkesën e paditësit për shtyrje të seancës , pasi paditësit njoftimin e ka pranuar karter javë para mbajtjes së seancës, dhe se paditësi ka pasur kohë të mjaftueshme për të gjetur zëvendësim te punëdhënësi, për të prezantuar në seancë dhe nuk e ka pranuar shtyrjen .

Në seancë dëgjimore përfaqësuesi i AKP-së ka propozuar të mirët aktgjykim për mos paraqitje.

Arsyetimi ligjor

Padia / Kërkesa e paditësit hedhet.

Me nenin 58 të Ligjit nr. 06/L-086, është paraparë ,, 1. Nëse pala kundërshtare, të cilës i është dorëzuar kërkesa, nuk paraqitet në seancë dëgjimore për të cilën është njoftuar sipas rregullit dhe me kohë, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës, sipas detyrës zyrtare, apo në bazë të kërkesës së Parashtruesit, mund të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër palës kundërshtare. 2. Nëse parashtrues i ftuar sipas rregullit nuk paraqitet në seancë dëgjimore apo nëse braktis procedurat, atëherë gjyqtari(ët) gjegjës mund, pas parashtrimit të kërkesës nga pala kundërshtare, të nxjerrë një Aktgjykim për mosparaqitje kundër Parashtruesit duke hedhur poshtë kërkesën dhe duke urdhëruar Parashtruesin që të paguajë të gjitha shpenzimet procedurale. 3. Para nxjerrjes së një aktgjykimi për mosparaqitje, gjyqtari(ët) gjegjës vlerëson se janë përmbushur të gjitha këto kushte: 3.1. kërkesa është e pranueshme; 3.2. faktet e pretenduara nga Parashtruesi mbështesin kërkesën;

Gjykata vlerëson se në rastin konkret, paditësi ishte i ftuar në mënyrë të rregullt, për seancën dëgjimore publike të mbajtur më dt. 19.09.2024, pasi njoftimin për mbajtjen e seancës dëgjimore ju është dorëzuar më dt. 22.08.2024. Paditësi s'bashku me njoftim për seancë dëgjimore, është njoftuar për pasojën juridike nëse nuk prezanton në seancë dëgjimore, në lidhje me zbatimin e nenit 58 të Ligjit nr. 06/L-086.

Gjykata vlerëson se në rastin konkret janë përmbushur të gjitha kriteret e parapara për marrjen e Aktgjykimit për mosparaqitje sipas nenit 58, paragrafi 3, lidhur me paragrafin 2, të Ligjit nr. 06/L-086, pasi paditësi është njoftuar për mbajtje të seancës dëgjimore për dt. 20.09.2024, ndërsa nuk ka prezantuar.

Shpenzimet Gjyqësore:

Në bazë të nenit 62 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme , u vendos që secila palë ti heqë shpenzimet e veta të procedurës .

Këshillë Juridike:

Kundër këtij aktgjykimi, sipas nenit 59, të Ligjit nr. 06/L-086, mund të ushtrohet kërkesë për prishje të aktgjykimit për mosparaqitje në afatin prej një muaj dite, Kërkesa i dorëzohet Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme dhe palës kundërshtare / të paditur.

Hasim Sogojeva, Gjyqtar